

Vendim nr. 68, datë 26.02.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 26.02.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 22 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “SHKOLLA E MESME JOPUBLIKE “SKËNDERBEJ”” sh.p.k.**, përfaqësuar nga avokati Adem Ajdini, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 80-2017-511, datë 15.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë; nr. 26 (86-2018-26), datë 16.01.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-1406, datë 24.04.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 20, 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja ka ushtruar aktivitetin e administrimit dhe të drejtimit didaktik të institucioneve arsimore parauniversitare jopublike. Në bazë të gjetjeve të inspektimit, të kryer pranë kërkuëses nga Inspektorati i Shtetëror i Arsimit, ministri i Arsimit dhe Sportit (*MAS*), me urdhrin nr. 460, datë 08.09.2016 “Për mbylljen e veprimtarisë së Shkollës së Mesme Jopublike, arsimit i mesëm i përgjithshëm “Skënderbej””, ka urdhëruar, ndër të tjera, mbylljen e veprimtarisë së kësaj shkolle (*urdhri nr. 460/2016*).

2. Duke mos qenë dakord me këtë urdhër, kërkuësja në datën 26.09.2016 ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar, ndër të tjera, kundërshtimin dhe shfuqizimin tërësisht si të paligjshëm dhe konstatimin si të pavlefshëm të urdhrin nr. 460/2016.

3. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 80-2017-511, datë 15.02.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova, pasi ka çmuar se urdhri nr. 460/2016 është i bazuar në ligj. Kundër këtij vendimi, në datën 22.02.2017, ka paraqitur ankim kërkuësja, ndërsa *MAS*-i ka paraqitur kundërankim, duke kërkuar mospranimin e ankimit.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 26 (86-2018-26), datë 16.01.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit 80-2017-511, datë 15.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, në datën 12.02.2018, ka paraqitur rekurs kërkuësja, e cila kërkuar prishjen e të dyja vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim, ndërsa *MAS*-i ka paraqitur kundërrekurs, nëpërmjet të cilit ka kërkuar mospranimin e rekursit, pasi pala paditëse (kërkuësja) ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 69/2012, datë 26.07.2012 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar (*ligji nr. 69/2012*) dhe se urdhri për heqjen e licencës dhe mbylljen e aktivitetit është plotësisht i drejtë.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të

ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Në datën 22.08.2025 kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 09.09.2025.

II

Pretendimet e kërkuësjes

7. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes*, pasi shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë në dhomën e këshillimit.

7.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka refuzuar rekursin, me arsyetimin formal se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, ndërkohë që thelbi i pretendimeve si në gjykimin në themel, ashtu edhe në ankim e rekurs lidhej pikërisht me zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykatat e faktit, çështje që, sipas saj, duhej të ishte shqyrtuar nga Gjykata e Lartë. Këto vendime janë rezultat i një interpretimi dhe zbatimi të gabuar të ligjit material dhe procedural, pasi asnjë nga këto vendime nuk ka arsyetuar konkretisht se cilat kanë qenë shkeljet e rënda ligjore të kritereve të licencimit që do të justifikonin masën ekstreme të heqjes së licencës dhe mbylljes së aktivitetit. Gjithashtu, këto gjykata nuk kanë marrë në konsideratë në mënyrë të plotë nëse duhej të ishte zbatuar neni 71 i ligjit nr. 69/2012, ndërkohë që përmes vendimeve të dhëna është legjitimuar një trajtim i pabarabartë dhe në kundërshtim me nenin 54 të po këtij ligji, i cili përcakton përgjegjësinë e drejtuesit të institucionit arsimor për zbatimin e legjislacionit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuësjes*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe

2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesja të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose të veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesen. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare. Edhe pse kriteret e legjitimitimit kanë të njëjtën peshë në këtë fazë të shqyrtimit paraprak, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, kjo nuk nënkupton se në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i më shumë se një kriteri, ato humbasin rëndësinë dhe karakterin kumulativ të tyre.

10. Në verifikim të plotësimimit të këtyre kriterëve, në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në analizën e legjitimitimit *ratione materiae*, duke evidentuar se kërkuesja ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

11. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes, kërkuesja ka pretenduar se shqyrtimi i çështjes në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë është bërë në dhomën e këshillimit. Sipas ligjit procedural, shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve. Në këto kushte, shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjyimit të përcaktuar nga ligji. Për më tepër, një formë e tillë gjykimi, edhe në rastet kur rekursi ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, nuk është vlerësuar nga Gjykata se cenon të drejtën e

palëve për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, duke u shprehur se shqyrtimi i rekursit në seancë në dhomën e këshillimit, pra mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, kjo e drejtë realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, Kolegji vëren se shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuases nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji, për rrjedhojë ky pretendim i saj është haptazi i pabazuar.

12. Kërkuësja ka pretenduar se edhe gjykatat e zakonshme nuk kanë vlerësuar drejt dhe në mënyrë objektive pretendimet e saj për interpretimin e gabuar të ligjit material e procedural, si dhe nuk kanë arsyetuar konkretisht se cilat kanë qenë shkeljet e rënda ligjore të kriterëve të licencimit që do të justifikonin masën ekstreme të heqjes së licencës dhe mbylljes së aktivitetit.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se arsyetimi është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për arsyetim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata ka pranuar se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se aktet administrative të kundërshtuara nga kërkuësja në atë gjykatë janë të bazuara në ligj dhe, për pasojë, padia duhet të rrëzohet. Kjo pasi ka rezultuar se kërkuësja ka kryer shkelje të rënda ligjore në veprimtarinë arsimore të lidhura me mbajtjen e parregullt të dokumentacionit shkollor (korrigjime të pasigluara në regjistra, mungesa të pallogaritura saktë dhe pa dokumentacion justifikues), regjistrimin e nxënësve në kundërshtim me kapacitetet dhe

procedurat ligjore, mosruajtjen e testeve të detyrave të kontrollit, si dhe ndryshimin e drejtuesit didaktik pa miratimin përkatës nga autoritetet kompetente. Edhe pretendimet e paditësit lidhur me ligjshmërinë e inspektimit janë analizuar nga ajo gjykatë e janë vlerësuar si të pabazuara. Ajo gjykatë është shprehur edhe për pretendimin e kërkueses se përgjegjësia për shkeljet ligjore në institucionet arsimore private duhet t'u atribuohet drejtuesve të institucionit e jo vetë institucionit si person juridik, duke e gjetur të pabazuar këtë pretendim, pasi kuadri ligjor përkatës nuk parashikon ndarje të përgjegjësisë ndërmjet institucionit privat dhe drejtuesve të tij, përkundrazi parashikohet vendosja e masave administrative ndaj institucionit arsimor privat.

15. Gjykata Administrative e Apelit, në vijim, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se inspektimi është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor, autorizimi i inspektimit është lëshuar nga organi kompetent dhe ka përmbajtur elementet e detyrueshme të parashikuara. Po kështu, mosnjoftimi paraprak i subjektit të inspektuar është gjetur i bazuar në ligj, për shkak të rrezikut të cenimit të efektivitetit të kontrollit, rrethanë që është arsyetuar shprehimisht në autorizim. Ajo gjykatë ka arsyetuar se shkeljet e kryera nga institucioni arsimor privat janë të mbështetura në prova shkresore, duke cenuar drejtpërdrejt kriteret e licencimit dhe të funksionimit të institucionit arsimor privat. Gjithashtu, edhe ajo gjykatë ka vlerësuar pretendimin e kërkueses në lidhje me pretendimin se përgjegjësia për shkeljet duhet t'u atribuohet drejtuesve individualë dhe jo institucionit, duke vërejtur se ky argument nuk gjen mbështetje në kuadrin ligjor në fuqi. Sipas asaj gjykate, ligji nuk parashikon ndarje të përgjegjësisë administrative ndërmjet personit juridik dhe drejtuesve të tij, por, përkundrazi, përcaktohet shprehimisht se masat administrative vendosen ndaj vetë institucionit arsimor privat. Për rrjedhojë, përgjegjësia ligjore për shkeljet e konstatuara rëndon mbi shkollën jopublike, si subjekt juridik.

16. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e rekursit ka verifikuar pretendimet e kërkueses, duke arritur në përfundimin se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në funksionin e saj kushtetues si gjykatë ligji, ushtron juridiksion rishikues vetëm brenda këtyre shkaqeve ligjore, ndaj është detyrë e rekursuesit t'i parashtrijë dhe t'i argumentojë ato qartë e plotësisht. Ajo gjykatë, në mungesë të parashtrimit dhe të argumentimit të këtyre shkaqeve, ka vendosur mospranimin e rekursit, pa qenë e nevojshme që të kryejë analiza të mëtejshme.

17. Nga sa më lart, Kolegji vë në dukje se për sa u përket pretendimeve të kërkueses për mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet e çështjes dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre, në thelb ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e të zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme dhe, si të tilla, nuk përfshihen në juridiksionin e kësaj Gjykate. Po kështu, nga analiza e vendimeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se nuk rezulton që çmuarja e provave ose zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme të ketë gabime faktike ose ligjore të dukshme që t'i bëjë vendimet gjyqësore arbitrare. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

18. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.